



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë
Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

KURRIKULA

**PËR TRAJNIMIN E PROFESIONISTËVE
PËR OFRIMIN E PROGRAMEVE PËR
KRYRËSIT E DHUNËS NË FAMILJE
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**


Nëntor, 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

**KURRIKULA PËR TRAJNIMIN E PROFESIONISTËVE
PËR OFRIMIN E PROGRAMEVE PËR KRYRËSIT E DHUNËS NË
FAMILJE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 334/2022
Datë: 02.12.2022

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (G.Z nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 (nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr.04/2021 dhe Rregulloren (QRK)-Nr. 03/2022, si dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022 – 2026), Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kurrikula për trajnimin e profesionistëve për ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës, i cili është bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministrisë së Shëndetësisë;
- Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- Institutit për Psikiatri Forenzike;
- Qendrave për Punë Sociale;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	4
HYRJE	5
1. GRUPI PUNUES PËR ZHVILLIMIN E PROGRAMEVE PËR KRYERËSIT E DHUNËS NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	4
2. KONVENTA E STAMBOLLIT E KËSHILLIT TË EVROPËS	7
PJESA I: ÇFARË JANË PROGRAMET PËR KRYERËSIT E DHUNËS?	9
1. ORIGJINA DHE LIGJI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT E NJERIUT	9
2. PARIMET KYÇE	9
3. QASJET KRYESORE	11
4. KONTEKSTI DHE FINANCIMI	12
5. SHEMBUJ TË PROGRAMEVE FRYMËZUESE	12
PJESA II: KURRIKULA E PROGRAMEVE PËR KRYESIT E DHUNËS NË FAMILJE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	19
1. OBJEKTIVAT	19
2. PARIMET DHE QASJET	20
3. KONTEKSTI LOKAL	21
4. STRUKTURA DHE KOHËZGJATJA	23
5. OFRIMI I PROGRAMIT DHE OFRUESIT E SHËRBIMIT	25
5.1 PROFESIONISTË TË PËRFSHIRË	25
5.2 PROCEDURAT E LICENCIMIT	26
6. REFERIMI NË PROGRAM	27
7. VLERËSIMI	29
PJESA III: MODULET DHE PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT	30
1. FORMAT E DHUNËS/ABUZIMIT NË FAMILJE	30
2. RROTA E PUSHTETIT DHE KONTROLLIT	31
3. MODULET	32
REFERENCA	42

Lista e shkurtesave

TGS	Terapia Kognitive e Sjelljes
LKBD	Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem
LKGV	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
DhF	Dhuna në Familje
PPDhF	Programet e Parandalimit të Dhunës në Familje
DhBGj	Dhuna me Bazë Gjinore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
HMPPS	Shërbimi i Burgut dhe Sprovues i Madhërisë së Saj
DhPI	Dhuna ndaj Partnerit Intim
ShIS	Shërbimet e Integruara të Sigurisë
PRIA-MA	Programi i Ndërhyrjes për Autorët e Dhunës në Masat Alternative
TPSA	Trajtimi Psikosocial i Autorëve të Dhunës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
ËËP EN	Rrjeti Evropian i Punës me Autorët e Dhunës në Familje
QBD	Qendra për Burra dhe Djem

Hyrje

“Kurrikula për trajnimin e profesionistëve për ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës” (në tekstin e mëtejme Kurrikula) synon të vendosë bazën për krijimin dhe zhvillimin e programeve të kryerësve të dhunës në Kosovë, në përputhje me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe standarde të tjera ndërkombëtare. Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës ka miratuar Kurrikulën, në mënyrë që zhvillimi, zbatimi dhe ofrimi i programeve të kryerësit e dhunës në familje në Kosovë në të ardhmen të jenë në përputhje me këtë dokument.

Kjo Kurrikulë është e ndarë në tri seksione kryesore:

1. Seksioni i parë përcakton se çfarë janë programet për kryerësit e dhunës në familje, duke përfshirë parimet kryesore, qasjet kryesore, kontekstin dhe financimin, dhe ofron shembuj të disa programeve frymëzuese në të gjithë Evropën.
2. Seksioni i dytë përshkruan se si programet e kryerësve të dhunës mund të zhvillohen dhe realizohen në Kosovë. Ai përcakton objektivat, parimet dhe qasjet, specifikat e kontekstit lokal, strukturën, kohëzgjatjen, ofrimin e shërbimeve dhe vlerësimin e programeve.
3. Seksioni i tretë përcakton modulet dhe përmbajtjen e tyre për çdo fazë dhe seancë të programit për kryerësit e dhunës. Ky version i Kurrikulës frymëzohet veçanërisht nga programi britanik Respect dhe, në këtë fazë, nuk bën dallime ndërmjet programeve të detyrueshme dhe vullnetare.

Kurrikula përmbush njëri nga obligimet që rrjedh nga Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, respektivisht Objektivi specifik I.4 “Krijimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës.” Kurrikula aktuale është konceptuar si një pilot, zbatimi i të cilit duhet të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë që të përshtatet më mirë me kontekstin dhe nevojat lokale

1. Grupi Punues për zhvillimin e kurrikulës së programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës

Grupi Punues për zhvillimin e kurrikulës për programet e kryerësve të dhunës në Kosovë është themeluar më 1 korrik 2022 me vendim zyrtar të Ministres së Drejtësisë së Kosovës. Kurrikula aktuale është rezultat i disa takimeve, punëtorive dhe diskutimeve kolegjiale të mbajtura ndërmjet prillit dhe tetorit 2022 dhe synohet të jetë bazë për një projekt pilot që synon zbatimin e programeve për kryerësit e dhunës në Kosovë.

Anëtarët e Grupit Punues ishin:

- Dr. Nita Shala, Zëvendësministre e Drejtësisë/Koordinatorë Nacionale kundër Dhunës në Familje, kryesuese
- Nazlie Bala, Ministria e Drejtësisë, anëtare

- Edi Gusia, Agjencia për Barazi Gjinore, anëtare
- Ruzhdi Osmani, Ministria e Drejtësisë, anëtar
- Florentina Beqiraj, Ministria e Drejtësisë, anëtare
- Merita Syla, Shërbimi Korrektues i Kosovës, anëtare
- Merita Gashi, Shërbimi Sprovues i Kosovës, anëtare
- Milazim Gjocaj, Ministria e Shëndetësisë, anëtar
- Përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar
- Adile Shaqiri, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtare
- Vebi Mujku, Qendra për Punë Sociale Prishtinë, anëtar
- Arsim Shala, Policia e Kosovës, anëtar
- Shenaj Berisha, Prokuror, anëtar
- Ngadhjim Arni, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar
- Dardan Kadolli, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar
- Shpend Haxhibeqiri, Instituti i Psikiatrisë Forenzike, anëtar
- Erblina Dinarama, Shtëpia e Sigurt Gjakovë, anëtare
- Kadri Gashi, SIT, anëtar
- Igballe Rogova, RRGK, anëtare
- Përfaqësues i OJQ EduTask, anëtar

Ky dokument është hartuar nga Cristina Oddone, konsulente ndërkombëtare dhe Adelina Toplica-Badivuku, konsulente vendore. Ky dokument është krijuar me mbështetjen financiare të Projektit "Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Faza III", zbatuar nga Këshilli i Evropës dhe bashkë financuar nga Belgjika, Gjermania, Irlanda, Norvegjia dhe Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojnë mendimin zyrtar të ndonjëres nga palët.

2. Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, gjithashtu e njohur si Konventa e Stambollit, është instrumenti ligjor ndërkombëtar më i gjerë për dhunën ndaj grave dhe e njeh dhunën ndaj grave si një formë diskriminimi ndaj grave dhe si shkelje të të drejtave të njeriut. Ajo bazohet në katër shtylla kryesore: parandalimi, mbrojtja, ndjekja penale dhe politikat e integruara. Kapitulli I i Konventës së Stambollit përcakton qëllimet, përkufizimet, barazinë dhe mos diskriminimin dhe detyrimet e përgjithshme të shteteve palë në zbatimin e këtij traktati ndërkombëtar. Këto elemente që diskutohen më tej në Raportin Shpjegues të Konventës së Stambollit.

Neni 16 i Konventës së Stambollit përcakton detyrime specifike për shtetet palë në lidhje me ngritjen e programeve parandaluese dhe të trajtimit për kryerësit e dhunës në familje. Neni 16, paragrafi 1 kërkon nga palët që të krijojnë ose mbështesin programe që parandalojnë kryerësit e dhunës në familje nga përsëritja e veprës penale dhe që nxisin ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme. Përveç kësaj, neni 16, paragrafi 3 thekson se *“palët duhet të garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e njeriut të viktimave janë shqetësimi parësor dhe se, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.”*

Ky seksion i kurrikulës kujton disa elementë që janë të rëndësishëm për zbatimin korrekt të programeve për kryerësit e dhunës, në përputhje me parimet e Konventës së Stambollit.

Qëllimi i Konventës (Neni 1)

- Qëllimi specifik i Konventës është **mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore të mbuluar nga fushëveprimtaria e saj**, si dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, që duhet të arrihet duke ndërmarrë masa globale dhe të koordinuara.
- Qëllimi i çrrënjësjes së dhunës ndaj grave është i lidhur ngushtë me arritjen e barazisë gjinore në ligj dhe në fakt: veprimet e parashikuara në Konventë synojnë të kontribuojnë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe në promovimin e barazisë thelbësore midis grave dhe burrave.
- Konventa kërkon miratimin e një kuadri gjithëpërfshirës, të bazuar në një qasje me bazë të drejtat e njeriut, në mënyrë që të **garantojë sigurinë e viktimave dhe të trajtojë pasojat shkatërruese të dhunës ndaj grave me baza gjinore.**
- Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave kërkon bashkëpunim të gjerë të shumë agjencive si pjesë e një qasjeje të integruar.

Fushëveprimi i Konventës (Neni 2)

- Konventa mbulon të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, dhe thekson se **shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra**, megjithëse edhe burrat dhe fëmijët mund të jenë subjekt i dhunës së tillë. **Dhuna me bazë gjinore ndaj grave** në manifestimet e saj të ndryshme, përfshirë dhunën në familje, duhet të qëndrojë në qendër të të gjitha masave të zbatuara.

Përkufizimet (Neni 3)

- **Dhuna ndaj Grave** duhet të kuptohet si dhunë ndaj të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi ndaj grave. Ajo përfshin të gjitha format e **dhunës me bazë gjinore** që rezultojnë në dëmtime ose **vuajtje fizike, seksuale, psikologjike** ose **ekonomike** për gratë, duke përfshirë kërcënimet, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, në jetën publike ose private.
- **Dhuna në familje** përfshin të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin në familje ose në njësinë familjare, pavarësisht nga lidhjet biologjike ose ligjore familjare. Dhuna në familje përfshin **dhunë nga partneri intim** ndërmjet partnerëve aktualë ose të mëparshëm dhe **dhunë ndërmjet brezave** që zakonisht ndodh midis prindërve dhe fëmijëve. Ky përkufizim neutral ndaj gjinisë përfshin viktimat dhe autorët e dhunës të të dy seksve. **Dhuna nga partneri intim dihet se prek gratë në mënyrë disproporcionale**, pra si **me gjini të dallueshme**. Në të dyja rastet, nuk kërkohet vendbanimi i përbashkët i viktimës dhe kryerësit të dhunës.
- **Gjinia** i referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhetributeve të ndërtuara sociale që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat. Rolet dhe stereotipet gjinore konsiderohen se kontribuojnë për ta bërë dhunën të pranueshme nga shoqëria. Në kuadër të Konventës, çrrënjësja e paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe praktikave të tjera të bazuara në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet e stereotipizuara gjinore konsiderohet si thelbësore për parandalimin e dhunës ndaj grave. Të gjitha format e dhunës të përmendura në Konventë duhet të adresohen **në kontekstin e pabarazisë mbizotëruese midis grave dhe burrave**, stereotipeve ekzistuese, roleve gjinore dhe diskriminimit ndaj grave.
- **Dhuna me bazë gjinore ndaj grave** i referohet dhunës që përdoret ndaj një gruaje për shkak se ajo është grua ose dhunës që prek gratë në mënyrë disproporcionale. Dhuna me bazë gjinore i referohet çdo dhune që ushtrohet ndaj grave dhe që është njëkohësisht shkak dhe rezultat i marrëdhënieve të pabarabarta të pushtetit, bazuar në dallimin e perceptuar midis grave dhe burrave, duke çuar në statusin e nënshtruar të grave në sferën private dhe publike. Dhuna e tillë është e rrënjësorë thellë në strukturat, normat dhe vlerat sociale dhe kulturore që qeverisin shoqërinë dhe shpesh kryhet nga një kulturë mohimi dhe heshtjeje. Kjo shprehje synon mbrojtjen e grave nga dhuna që vjen nga stereotipet gjinore dhe në mënyrë specifike përfshin gratë.
- **Viktima** përfshin si viktimat e dhunës ndaj grave ashtu edhe viktimat e dhunës në familje. Ndërsa vetëm gratë dhe vajzat (nën 18 vjeç) mund të jenë viktima të dhunës ndaj grave, burrat dhe djemtë (nën 18 vjeç) mund të përfshihen në mesin e viktimave të dhunës në familje.
- **Gratë** përfshin vajzat nën moshën 18 vjeç.

Pjesa I: Çfarë janë programet për kryerësit e dhunës?

1. Origjina dhe ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Puna me kryerësit e dhunës filloi rreth viteve 1970-ta si praktikë profesionale eksperimentale që synonte "rehabilitimin" e burrave të dhunshëm. Së pari në Amerikën e Veriut dhe në Mbretërinë e Bashkuar, më vonë në vende të tjera evropiane, programe të tilla janë konceptuar si një strategji që, duke reduktuar përsëritjen e veprës penale, mund të kontribuojë në sigurinë e viktimave (Këshilli i Evropës 2014; Westmarland, Kelly 2012; 2016). Kur dhuna ndaj grave u shfaq si një çështje me interes publik, si hulumtimi ashtu edhe praktika janë fokusuar me të drejtë në përvojën e viktimave dhe kanë priorizuar nevojën e tyre për mbrojtje dhe mbështetje. Punëtorët e strehimoreve filluan të vinin re se gratë u drejtoheshin shërbimeve të specializuara në disa raste, pasi sjellja e abuzuesit vështirë se do të reflektonte ndonjë ndryshim. Duke ndjekur shembullin e pararendësve të modelit Duluth (Pence, Paymar 1993) dhe programit Emerge (Gondolf 1985; Gondolf, Russell 1986), në shumicën e rasteve këto ndërhyrje të para synonin si përgjigje të koordinuara të komunitetit ndaj dhunës në familje, në bashkëpunim me shërbimet mbështetëse të grave. Duke i bërë përgjegjës abuzuesit në familje për veprimet e tyre, programet për kryerësit e dhunës synoheshin si një mënyrë për të përmirësuar reagimet ndaj viktimave dhe kryerësve të dhunës.

Në fillim të viteve 1990-ta, miratimi i reformave specifike të drejtësisë penale tregoi gjithashtu limitet e një qasjeje vetëm ndëshkuese ndaj kryerësve të dhunës (Hearn 1998), duke çuar në një nxitje për nisma rehabilituese. Që nga vitet e 2000-ta, disa programe për kryerësit e dhunës u zbatuan në të gjithë Evropën, megjithëse jo në mënyrë konsistente dhe pa një qasje të standardizuar. Ato filluan të zhvillohen, jo vetëm në mjedise jo-kujdestare mbi bazën e vetëreferimit, por edhe brenda sistemeve sprovuese dhe në burg. Nga Konferenca e OKB-së në Pekin për statusin e grave (1995) deri në hyrjen në fuqi të Konventës së Stambollit (2014), puna me kryerësit e dhunës mori vëmendje të shtuar. Në vitin 2008, Këshilli i Evropës përfshiu një seksion specifik mbi programet për kryerësit e dhunës në manualin e tij mbi standardet minimale për shërbimet mbështetëse për gratë viktime të DhF-së.

Të përfshira në Kapitullin III mbi "Parandalimin", Neni 16 i Konventës së Stambollit kërkon që shtetet palë të krijojnë programe për kryerësit e dhunës që synojnë edhe kryerësit e dhunës në familje por edhe dhunuesit seksual. Që nga viti 2018, organizata ombrellë e rrjetit "Rrjeti Evropian i Punës me Autorët e Dhunës në Familje" (WWP EN) ka zhvilluar udhëzimet e para për një zbatim korrekt të programeve të kryerësve të dhunës në përputhje me dispozitat e Konventës së Stambollit (WWP EN, n.d.).

2. Parimet kyçe

Hulumtimet dhe praktikat në këtë fushë kanë treguar se këto ndërhyrje, qofshin të bazuara në pjesëmarrje vullnetare ose të detyrueshme, mund të zvogëlojnë rreziqet për forma të mëtejshme dhe më të rënda të abuzimit. Në kontekstin e një procedure vlerësimi nga vendi-në-vend, Grupi i Ekspertëve i Këshilli i Evropës për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) – organi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Stambollit nga shtetet palë – ka vëzhguar një gamë të gjerë praktikash në lidhje me këtë dispozitë.

VËREJTJE!

PROGRAMET PËR KRYERËSIT E DHUNËS NUK JANË...

Është e rëndësishme të theksohet se programet për kryerësit e dhunës nuk duhet të reduktohen në abuzimin me alkoolin dhe substancat, menaxhimin e zemërimit, ose mjekim dhe se ato kurrë nuk duhet të synojnë pajtimin e partnerëve ose ofrimin e ndërmjetësimit midis bashkëshortëve.

Prandaj, programet për kryerësit e dhunës nuk janë vetëm:

- Seanca të menaxhimit të zemërimit
- Seanca të terapisë
- Terapi e abuzimit me drogën dhe alkoolin
- Këshillim ose ndërmjetësim i çiftit
- Programe të mbështetjes për prindërit

Të gjithë këto elemente mund të përfshihen në një kurrikulë, por puna me kryerësit e dhunës **nuk mund të kufizohet në këto aspekte.**

Duhet mbajtur mend se puna individuale dhe në grup me kryerësit e dhunës nuk është një mundësi për abuzuesit:

- Për të ndarë pikëpamjet seksiste dhe për të mbështetur njëri-tjetrin
- Për të justifikuar sjelljen e tyre të dhunshme
- Për të gjetur një mënyrë të lehtë për të kënaqur gjykatat në mënyrë të rifitojnë kontaktin ose të ribashkohen me partnerët e tyre

Programet për kryerësit e dhunës duhet të kenë gjithmonë prioritet mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurinë e viktimave, duke pranuar dhunën në familje si një strategji për burrat për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi partneret e tyre intime.

Programet për kryerësit e dhunës mund të ofrohen nga organizata të shoqërisë civile ose nga agjenci statutorë si shërbimet sprovuese dhe administratat e burgjeve. Qoftë të integruara me drejtësinë penale ose me një reagim të bashkërenduar të komunitetit, ose të drejtuara nga organizata të pavarura, programet e kryerësve mund të bazohen në disa kuptime teorike të dhunës në familje.

Pavarësisht qasjeve të ndryshme të vëzhguara nga GREVIO gjatë procedurës së parë të vlerësimit, **parimet kryesore për praktikë** janë:¹

- Prioriteti i **sigurisë së viktimës**;
- Marrja parasysh se **dhuna është gjithmonë një zgjedhje**, është gjithmonë e papranueshme dhe kryerësit e dhunës duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre;
- Për të hartuar një plan individual dhe një **reagim të bashkërenduar të komunitetit dhe ndërinstitucional** për të frenuar dhunën e burrave dhe për të

¹ Rishikimi horizontal afatmesëm i raporteve të vlerësimit bazë të GREVIO (2022). Gjetet në: <https://edoc.coe.int/en/violence-against-women/11030-mid-term-horizontal-review-of-grevio-baseline-evaluation-reports.html>

reduktuar përsëritjen e veprës penale, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.

Programet për kryerësit e dhunës në familje janë njëkohësisht një ndërhyrje në nivel individual dhe një përgjigje në nivel komunitar dhe strukturor, pasi ato tregojnë se dhuna në familje nuk duhet toleruar kurrë. Për profesionistët që realizojnë programin, kjo përkthehet në detyrimin për të punuar me personin fizik (duke kuptuar situatën dhe nevojat e tij) duke kuptuar dhunën në familje si një fenomen strukturor.

3. Qasjet kryesore

Sipas standardeve ndërkombëtare, programet për kryerësit e dhunës në familje duhet të bazohen në një perspektivë gjinore dhe në një qasje të përqendruar tek viktimat. Edhe pse ekzistojnë një mori programesh për kryerësit e dhunës, ato që njihen si më efektive kombinojnë qasje të ndryshme:

Qasje psiko-edukative të bazuara në njohuri gjinore të dhunës në familje (qasja pro-feministe): dhuna e burrave ndaj grave konsiderohet si rezultat i pabarazive gjinore dhe ideologjisë patriarkale; abuzimi i burrave konsiston në një sërë taktikash për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi gratë.

Terapia kongnitive e sjelljes (TGS), e cila e konsideron dhunën në familje si shprehje të qëndrimeve joadekuate mendore dhe emocionale të kryerësit e dhunës. Sipas kësaj qasjeje, sjellja e dhunshme është një sjellje e mësuar që mund të çmësohet dhe të zëvendësohet me qëndrime të reja. Programet kongnitive të sjelljes theksojnë përdorimin e përsëritur të shkathtësive ose aftësive të reja, pasi kryerësit e dhunës do të motivohen të sillen në mënyrë jo të dhunshme duke parë efekte pozitive tek ata që i rrethojnë (përforsim pozitiv);

VËREJTJE! JO TË GJITHA QASJET FUNKSIONOJNË...

Është e rëndësishme të theksohet se jo të gjitha qasjet mund të përfshihen në punën me kryerësit e dhunës. Për shembull, **këshillimi i çiftit** kritikohet për rritjen e rreziqeve për gratë viktimat dhe se i bën ato të ndajnë përgjegjësinë për abuzimin e kryer nga kryerësit e dhunës. Në anën tjetër, **qasje të individualizuara** janë kritikuar edhe për fokusim ekskluzivisht në nevojat e pacientit/klientit, ndërkohë që neglizhojnë nevojat dhe të drejtat e viktimave dhe mekanizmat strukturorë të dhunës në familje.

Sot, shumica e programeve për kryerësit e dhunës në familje në të gjithë Evropën dhe MB-në kombinojnë qasje dhe teknika të ndryshme, bazuar në lloje të ndryshme trajtimesh si TGS, qasje psikodinamike dhe pro-feministe. Shumë programe ndikohen shumë nga modeli Duluth i pushtetit dhe kontrollit, i realizuar në një format sesioni të strukturuar si pjesë e një përgjigjeje të koordinuar holistike. Të gjitha programet e përdorura si ndërhyrje ruajnë standardet e akreditimit bazuar në perspektivën gjinore dhe mbështetjen e viktimave (Respect 2018).

MODELI DULUTH I PUSHTETIT DHE KONTROLLIT

www.duluthmodel.org

I nisur nga një grup profesionistësh në Minesota në vitet 1980-ta, "modeli Duluth" është një mënyrë gjithnjë në zhvillim e të menduarit se si një komunitet punon së bashku për t'i dhënë fund dhunës dhe abuzimit në familje. Qasja e modelit Duluth:

- ka hequr fajin e viktimës dhe ia ka ngarkuar përgjegjësinë për abuzim kryerësit të dhunës;
- ka politika dhe procedura të përbashkëta për t'i mbajtur përgjegjës kryerësit e dhunës dhe për t'i mbajtur viktimat të sigurta në të gjitha agjencitë në sistemet e drejtësisë penale dhe civile prej raportit të parë në polici deri te gjykata;
- prioritetizon zërat dhe përvojat e grave që përjetojnë dhunë në krijimin e atyre politikave dhe procedurave;
- beson se dhuna është një model veprimesh të përdorura për të kontrolluar ose dominuar qëllimisht një partner intim dhe punon në mënyrë aktive për të ndryshuar kushtet shoqërore që mbështesin përdorimin nga burrat të taktikave të pushtetit dhe kontrollit mbi gratë;
- ofron mundësi ndryshimi për kryerësit e dhunës përmes grupeve arsimore të urdhëruara nga gjykata;
- ka diskutime të vazhdueshme midis agjencive të drejtësisë penale dhe civile, anëtarëve të komunitetit dhe viktimave për të mbyllur boshllëqet dhe për të përmirësuar reagimin e komunitetit ndaj dhunës.

Qasjet psiko-edukative të bazuara në modelin Duluth përdorin teknika terapeutike të provuara për të dënuar modelet e sjelljes së dhunshme, ndërkohë që operojnë përforcim pozitiv të qëndrimeve jo të dhunshme; programet kognitive të sjellëse përfshijnë aktivitete që synojnë të sfidojnë qëndrimet patriarkale që legjitimojnë dhunën ndaj grave. Në të gjitha rastet, përvoja praktike dhe vlerësimi sugjerojnë se çdo ndërhyrje duhet të marrë parasysh motivimin e kryerësit e dhunës për të ndryshuar (BFEG 2016).

Marrëveshjet me shërbimet mbështetëse të grave mund të sjellin gjithashtu kufizime në të drejtat e konfidencialitetit të kryerësve të dhunës. Përpara se të regjistrohet në një program, kryerësi i dhunës duhet të pranojë kushte specifike si dhënia e adresës së partnerëve aktualë dhe të mëparshëm dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje për lëshimin e informacionit konfidencial, veçanërisht në rastin e rritjes së rreziqeve për sigurinë e viktimave. Partnerët duhet të informohen gjithmonë nëse kryerësi i dhunës largohet nga programi, nëse ai është pezulluar për trajtim dhe nëse ka ndonjë shqetësim në lidhje me mirëqenien e grave dhe fëmijëve (Këshilli i Evropës 2008).

Gjetjet e hulumtimit nga projekti MIRABAL, të kryer në MB në vitin 2015, theksojnë se vlerësimi i programeve duhet të bëhet nga këndvështrimi i viktimës. Ekipi hulumtues MIRABAL ka identifikuar gjashtë masa të suksesit – të paraqitura si ndryshim nga fillimi në intervistën përfundimtare dymbëdhjetë muaj pasi një burrë filloi në një program për kryerësit e dhunës. Të tilla "lëvizje drejt ndryshimit" përfshijnë:

- (1) Komunikimi me respekt;

- (2) ‘Hapësirë për veprim’ të zgjeruar;
- (3) Siguria dhe liria nga dhuna dhe abuzimi për gratë dhe fëmijët;
- (4) Prindërimi i përbashkët;
- (5) Ndërgjegjësimi i vetvetes dhe të tjerëve;
- (6) Fëmijëri më të sigurta dhe më të shëndetshme.

Këta tregues bazohen në njohuri të gjerë të nocionit "sukses" dhe tregojnë papërshtatshmërinë e vlerësimeve të thjeshta "programi i kryer" ose "pa recidivizëm". Në përfundime, autorët ftojnë të marrin në konsideratë të gjithë procesin e ndryshimit të burrave dhe të nënvizojnë rëndësinë e përqendrimit në ndikimin e tij tek gratë dhe fëmijët (Kelly, Ëestmarland 2015).

4. Konteksti dhe financimi

Programet për kryerësit e dhunës mund të ofrohen në kontekste të ndryshme: në burg dhe në kontekstin e shërbimeve sprovuese për kryerësit e dënuar për dhunë; në komunitet, për kryerësit e dhunës që marrin pjesë në baza vullnetare. Në varësi të kontekstit, mund të përfshihen disa institucione dhe agjenci, si Ministria e Drejtësisë (shërbimet e burgjeve dhe sprovuese), Ministria e Shëndetësisë (shërbimet shëndetësore lokale dhe shërbimet sociale), Ministria e Politikave Sociale dhe Familjare, Ministria e Arsimit (në aktivitetet parandaluese në shkolla), organizatat me bazë në komunitet, universitetet dhe institutet kërkimore. Sipas konteksteve, duhet të ndahen burime të mjaftueshme financiare për programe të tilla. Siç theksohet në udhëzimet e përpunuara nga WWP EN, aleancat ndër-institucionale duhet të pranohen nga politikëbërësit dhe për këtë arsye duhet të financohen siç duhet, në mënyrë që të shmangët konkurrenca ndërmjet shërbimeve. Një vështrim i praktikave nga vendet e tjera mund të jetë burim frymëzimi se si të integrohen programet për kryerësit e dhunës në çdo kontekst kombëtar.

5. Shembuj të programeve frymëzuese²

Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (LKBD) (Shqipëri)

Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem (LKBD)³ është programi i parë për kryerësit e dhunës në Shqipëri. Ajo u krijua nga Linja e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat (LKGV), linja telefonike kombëtare për viktimat e dhunës në familje aktive që nga viti 1994. Në vitin 2010, LKGV-ja zhvilloi një shërbim të veçantë që synonte rehabilitimin e kryerësve të dhunës në familje. Fillimisht, profesionistët ofruan seanca individuale këshillimi për partnerët meshkuj të grave të akomoduar në strehimoren e tyre. Kjo praktikë eksperimentale pilot tregoi potencialin e punës me ata që kryejnë abuzimin dhe për pasojë u kthye në një projekt të plotë të nisur në vitin 2010. Pas një vlerësimi kombëtar të nevojave, LKGV-ja identifikoi kërkesat konkrete të shprehura nga shërbimet dhe institucionet vendore në lidhje me trajtimin e kryerësve të dhunës. Në vitin 2011, disa profesionistë iu nënshtruan një trajnimi dyvjeçar me fokus punën me kryerësit e dhunës, të ofruar nga Iamaneh Zvicër⁴ dhe duke përfshirë vizita

² Më shumë informacion mbi programet për kryerësit e dhunës në rajon është në dispozicion në Jovanović dhe Vall (2022).

³ Për më shumë informacion, uebsajti zyrtar gjendet në: <https://hotlinealbania.org/>. Shih edhe seksionin “Programet dhe praktikat nga rajoni i Ballkanit” në Këshillin e Evropës “Analiza e kornizës ligjore të Kosovës* dhe raporti i praktikave të mira” (2021):

<https://rm.coe.int/research-on-perpetrator-treatment-programmes-kosovo-eng/1680a24362>.

⁴ Për më shumë informacion, uebsajti zyrtar gjendet në: <https://www.iamaneh.ch/en/about-us/>

studimore në qendrat zvicerane të Bazelit dhe Cyrihut. Në nëntor 2012, LKBD-ja u inaugurua zyrtarisht në Tiranë.

Përveç ofrimit të seancave këshillimore për kryerësit e dhunës mbi baza vullnetare, gjatë viteve LKBD-ja ka punuar me gjykatat dhe me Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar një sistem referimi në programet e detyrueshme për kryerësit e dhunës mbi bazën e një dënimi gjyqësor. Sot, kryerësit e dhunës nga disa rrethe shqiptare mund të drejtohen në një program me urdhër të gjykatës të drejtuar nga LKBD-ja. Përveç kësaj, marrëveshje *ad hoc* janë nënshkruar me Zyrën e Provës dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Qendrave të Burgjeve për të lejuar trajtimin e kryerësve të dhunës brenda sistemit penitenciar. Kryerësit e dhunës që regjistrohen në një program duhet të marrin pjesë në të paktën 16 seanca javore dhe deri në 30 seanca. Parandalimi i braktisjes dhe sigurimi i pjesëmarrjes së vazhdueshme si në mjediset kujdestare ashtu edhe në ato jo-kujdestare janë identifikuar si sfida serioze, si dhe nevoja për të ndjekur ndjekjen kur një autor i dhunës lirohet nga burgu, në mënyrë që të shmanget recidivizmi.

Kohët e fundit, LKBD-ja ka identifikuar edhe nevojën për të ofruar module specifike trajnimi mbi sjelljet e varësisë – duke përfshirë varësinë ndaj alkoolit dhe drogës, lojërave të fatit, etj. – në mënyrë që këto çështje të trajtohen veçmas dhe kryerësit e dhunës të mund të orientohen drejt qendrave të specializuara të rehabilitimit. Modulet e ardhshme të trajnimit do të fokusohen edhe në punën me dhunuesit seksualë, të cilat do të integrohen në reformat e vazhdueshme gjyqësore dhe politikat e reja që synojnë trajtimin e dhunës seksuale dhe përdhunimit në Shqipëri.

Sot LKBD-ja punon në bashkëpunim me gjykatat, shërbimin e provës dhe agjenci të tjera ligjore. Ajo është e përkushtuar për të ofruar këshillim për kryerësit e dhunës, si dhe për të nxitur parandalimin dhe aktivitetet edukative për të ndihmuar në krijimin e një komuniteti në të cilin dhuna nuk tolerohet. Që nga themelimi i saj, LKBD-ja është pjesë e WWP EN dhe merr pjesë aktive në takimet vjetore dhe vizitat studimore. Që nga viti 2012 ka trajnuar shumë këshilltarë në të gjithë vendin dhe në vitin 2014 themeloi Qendrën për Burra dhe Djem (QBD) në Shkodër. Gjatë viteve ajo ka zhvilluar gjithashtu shkëmbime informale dhe partneritete të përbashkëta me programe të tjera në vendet fqinje, si Bosnja dhe Hercegovina. Ndarja e praktikave të mira konsiderohet e një rëndësie jetike për të diskutuar sfidat dhe përmirësimet e mundshme në punën me kryerësit e dhunës në familje, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit.

Programi TPSA dhe "Ti mund ta bësh ndryshe" (Kroaci)

Që nga fundi i viteve të 2000-ta, Kroacia e ka njohur rëndësinë e punës me kryerësit e dhunës në familje dhe dhunuesit seksualë. Programet mund të mbahen ose në komunitet ose në kujdestari, varësisht nëse rasti është klasifikuar si kundërvajtje ose si vepër penale.

Programi TPSA (Trajtimi Psikosocial i Autorëve të Dhunës) u inaugurua në vitin 2009 nga Dom Duga Zagreb, organizata e parë që ofron këshillim dhe mbështetje për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës në familje.⁵ Programi vlen vetëm për autorët e akuzuar për kundërvajtje dhe zhvillohet në një mjedis jo-kujdestar. Programi TPSA nuk kufizohet vetëm tek burrat autorë të abuzimit me partnerin intim, pasi pranon edhe gratë autore dhe autorë të formave të ndryshme të dhunës në familje, si dhuna ndaj prindërve të moshuar apo ndaj të miturve. Në secilin prej këtyre rasteve, ofruesit e shërbimeve duhet t'i përshtatin modulet me llojin e

⁵ Më shumë informacion gjendet në: www.duga-zagreb.hr

dhunuesit. Është e rëndësishme të theksohet se programi nuk pranon persona me çrregullime të rënda të shëndetit mendor, me probleme të varësisë ose me motivim të ulët për të ndryshuar. Siguria e viktimës është një nga shtyllat kryesore të programit dhe për këtë qëllim kontaktohet viktimja në disa faza. Sot, Dom Duga Zagreb është organizatë anëtare e WWP EN.

Që nga viti 2018, programi "Ti mund ta bësh ndryshe" zbatohet nga Shërbimi Sprovues me fokus të veçantë trajtimin e kryerësve të dhunës në familje. Programi është zhvilluar në kuadër të programeve mbështetëse të BE-së për zhvillimin e shërbimeve sprovuese. Në veçanti, "Drejtoria e Përgjithshme e Regjimit të Hapur dhe Dënimeve dhe Masave Alternative" pranë Ministrisë së Brendshme në Spanjë kanë ofruar trajnime specifike për masat rehabilituese për kryerësit e dhunës me bazë gjinore. Shumica e ofruesve të shërbimeve kanë një përvojë në psikologji, punë sociale dhe pedagogji. Programi bazohet në punën në grup (grupe nga 8 deri në 10 pjesëmarrës), por në rast të një numri të vogël autorësh, në vend të tyre mund të ofrohen seanca individuale këshillimi.

Qëllimi kryesor i "Ti mund ta bësh ndryshe" është zvogëlimi i DhBGj-së. Objektiva të tjerë përfshijnë kufizimin e faktorëve të rrezikut, ndryshimin e qëndrimeve seksiste dhe promovimin e koncepteve të reja të shëndetshme të karakterit mashkullor. Si program TPSA, ai është i strukturuar në tri faza: një fazë motivuese, një fazë ndërhyrje dhe një fazë monitorimi. Meqenëse grupi i parë i shkelësve tregoi kënaqësi të madhe me programin, institucionet po planifikojnë të zhvillojnë një projekt kërkimor specifik për të vlerësuar rregullisht efektivitetin e programit.

PRIA-MA-ja, Programi i Ndërhyrjes për Kryerësit e Dhunës në Masat Alternative [në paraburgim] (Spanjë)

Sot në Spanjë ekzistojnë lloje të ndryshme programesh për kryerësit e dhunës në familje: brenda komunitetit (si pjesëmarrje vullnetare në programet e drejtuara nga organizatat e shoqërisë civile) dhe brenda kuadrit gjyqësor, në varësi të Ministrisë së Brendshme, Zyrës së Institucioneve Penitenciare (në mjedise kujdestare për kryerësit e dhunës me dënim me burg, në mjedise jo-kujdestare si masë alternative në paraburgim).

Për sa i përket programeve vullnetare, peizazhi kombëtar spanjoll është shumë heterogjen, gjë që është pjesërisht për shkak të mungesës së financimit të qëndrueshëm. Megjithatë, në vitin 2006 një grup ekspertësh në fushën e dhunës me bazë gjinore, kryesisht të specializuar në mbështetjen e grave dhe të miturve të ekspozuar ndaj dhunës në familje, hartuan një manual standard për trajtimin e kryerësve të dhunës, që përmban ndërhyrje dhe udhëzime ligjore (Geldschläger 2011). Programet e pjesëmarrjes vullnetare shpesh mbështeten nga financimi prej institucioneve lokale (si qeveria komunale ose rajonale), në baza të rastësishme ose nëpërmjet kontratave afatshkurtra. Është rasti i Shërbimit të Kujdesit për Burra (SAH) aktiv që nga viti 2005 për Këshillin e Qytetit të Barcelonës⁶, nga Contexto në Valencia⁷, i Shërbimit të Kujdesit Psikologjik për Burra i Qeverisë së Aragonës, nën

⁶ Më shumë informacion mbi *Shërbimin e Kujdesit për Burrat (SAH)* është në dispozicion për shkarkim nga Bashkia e Barcelonës: <https://ajuntament.barcelona.cat/dones/es/information-and-attention/information-and-attention-men/men-attention-program-sah>

⁷ Për sa i përket programit Contexto, shih uebfaqen e internetit: <https://www.programacontexto.org>

përgjegjësini e Institutit lokal të Grave (IAM)⁸, i Programit të Riedukimit për kryerësit e dhunës me bazë gjinore në Andaluzi⁹ dhe e Hapjes së Rrethit, nën Qeverinë Rajonale të Galicisë¹⁰.

Në 20 vitet e fundit, zbatimi i praktikave eksperimentale, miratimi i një manuali dhe vlerësimet sistematike të rezultateve kanë lejuar përpunimin e standardeve kombëtare që rishikohen dhe përditësohen vazhdimisht në dritën e konsideratave të reja. Programi PRIA-MA, i nisur në vitin 2017 nën Ministrinë e Brendshme spanjolle, rezultoi nga ky proces i frytshëm "provash dhe gabimesh".

Ndërsa një projekt eksperimental për kryerësit e dënuar u aktivizua për herë të parë në burg në vitin 2001, Ligji Organik i vitit 2004 mbi dhunën me bazë gjinore¹¹ krijoi një kuadër gjithëpërfshirës për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe vendosi ndërhyrje specifike brenda sistemit gjyqësor nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm të Institucioneve Penitenciare.¹² Pas vlerësimit të një piloti, një program i parë i quajtur "Programi i Trajtimit të Burgut për Kryerësit e Dhunës në Familje" u aplikua midis vitit 2005 dhe 2010. Përmbajtja dhe struktura e ndërhyrjes u detajua në një manual të parë që synonte stafin e burgut dhe profesionistët e tjerë aktivë në këtë fushë (San Martín *et al.* 2005).

Në një fazë të dytë, institucionet kombëtare zhvilluan një program ndërhyrjeje për kryerësit e dënuar me masa alternative në paraburgim, me qëllim të reduktimit të recidivizmit për veprat penale të dhunës në familje (Pérez Ramírez *et al.* 2017): programi PRIA (Programi i Ndërhyrjes për Autorët e Dhunës) u krijua në vitin 2010 dhe përfaqësoi një pikë kthese në trajtimin e agresorëve në Spanjë (Ruiz Arias *et al.* 2010).

Pas një vlerësimi të plotë, në vitin 2017 programi PRIA u rishikua dhe u zëvendësua me PRIA-MA (Programi i Ndërhyrjes për Autorët e Dhunës në Masa Alternative [në paraburgim])¹³, bazuar në disa objektiva thelbësorë: (1) eliminimi i sjelljeve të dhunshme dhe reduktimi i recidivizmit; (2) eliminimi i faktorëve të rrezikut që konsiderohen të rëndësishëm në kryerjen e dhunës në familje; (3) rritja e motivimit dhe interesit personal të autorëve të dhunës në lidhje me trajtimin; dhe (4) përmirësimi i reagimit psikologjik të kryerësve të dhunës. Një manual i ri i rishikuar ka rafinuar metodologjinë e ndërhyrjes, duke adoptuar një perspektivë të qartë gjinore dhe një këndvështrim kritik mbi sjelljet që lidhen kulturalisht me karakterin mashkullor normativ (Suárez Martínez *et al.* 2015). Abuzuesit duhet të marrin pjesë në seancat individuale dhe grupe për një periudhë afërsisht dhjetë mujore, si masë e detyrueshme e vendosur nga gjyqtari si alternativë ndaj burgut.

⁸ *Shërbimi i kujdesit psikologjik për burra*. Më shumë informacion në dispozicion këtu: http://www.aragon.es/DepartamentosOrganismosPublicos/OOAA/InstitutoAragonesMujer/AreasTematicas/ServiciosAsesorias/ci.Servicio-de-atención-psicológica-para-hombres_detalleDepartamento

⁹ Më shumë informacion në dispozicion në uebsajtin zyrtar të Rajonit Andalucia: https://www.juntadeandalucia.es/igualdadybienestarsocial//export/Violencia_Genero/HTML/actuacionesdvgv.html

¹⁰ *Hapja e Rrethit. Program për familjet me probleme të kontrollit të dhunës*, në uebsajtin zyrtar të Qeverisë së Galicisë: <http://igualdade.xunta.gal/es/recursos/abramos-o-circulo-programa-para-homes-con-problemas-de-control-de-violencia>

¹¹ *Ligji Organik 1/2004*, Titulli IV, Neni 42.

¹² Faqja zyrtare e Sekretariatit është në dispozicion në këtë adresë: <http://www.institucionpenitenciaria.es>

¹³ Uebsajti zyrtar është në dispozicion këtu:

<http://www.institucionpenitenciaria.es/ëeb/portal/PenasyMedidasAlternativas/programas/priama.html>

Programi organizohet në tri faza kryesore:

- (1) Faza e motivimit dhe e vlerësimit. Disa takime individuale synojnë krijimin e një 'plani motivues' për secilin pjesëmarrës, duke eliminuar qëndrimet e rezistencës dhe duke nxitur interesin për ndryshime të thella personale;
- (2) Faza e ndërhyrjes. Disa aspekte thelbësore të trajtimit trajtohen në mënyrë progresive në këtë fazë, si zhvillimi i inteligjencës emocionale, shkathtësitë e vetëkontrollit, menaxhimi i zemërimit, mbështetja për vetëvlerësimin dhe ndjeshmërinë, ndryshimi i besimeve seksiste dhe qëndrimet mizogjene, ndërgjegjësimi për pasojat e dhunës ndaj të miturve etj.;
- (3) Faza përcjellëse. Gjatë kësaj faze, profesionistët kryejnë një vlerësim të ndryshimeve individuale të ndodhura dhe hartojnë një vlerësim të personalizuar të objektivave të arritura dhe shtigjeve të mundshme pasuese.

Programi aplikohet në mbarë vendin dhe vlerësimi periodik i tij i është besuar Nënsekretariatit të Përgjithshëm të Ndëshkimeve dhe Masave Alternative, në bashkëpunim me Institutin e Shkencave Mjekoligjore dhe të Sigurisë të Universitetit Autonom të Madridit. Në çdo Komunitet Autonom të shtetit spanjoll, lloje të ndryshme organizatash (OJQ, shoqata, universitete, etj.) janë përgjegjëse për menaxhimin e programeve sipas standardeve të kërkuara nga Ministria e Brendshme, në veçanti Zyra e Institucioneve të Ndjekjes, e cila është përgjegjëse për marrëdhëniet e drejtpërdrejta me shkelësit. Ndër organizatat përgjegjëse për zbatimin e programeve, vlen të përmendet Fondacioni Aspacia në Madrid dhe programi Contexto në Valencia, të dyja të njohura për angazhimin e tyre në punën me autorët e dhunës dhe në kërkime.

Programet e akredituara nga Respect (Mbretëria e Bashkuar)

Respect është një organizatë me bazë në Mbretërinë e Bashkuar, roli i së cilës është të vendosë standarde për ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës, të ilustrojë praktikën më të mira dhe të drejtë praktikuesit dhe abuzuesit. Respect është një organizatë bamirëse e financuar nga qeveria që siguron që të gjithë, përfshirë kryerësit, të mbijetuarat, financuesit, komisionerët dhe praktikuesit, mund të sigurohen se një shërbim është i një standardi të cilësisë së lartë, monitorohet rregullisht dhe mbështetet për të reflektuar dhe përmirësuar shpesh praktikën më të mira të punës. Programe të shumta efektive të kryerësve të dhunës aktualisht aktive në MB rregullohen nga Respect: ato kanë një kohëzgjatje të gjatë (24 javë ose më shumë), ato ofrohen në një bazë të kombinuar sesionesh individuale dhe grupe dhe përdorin një përzjerje të qasjeve të ndryshme.

Make a Change është një përgjigje e hershme në mbarë komunitetin ndaj njerëzve që janë të shqetësuar se po abuzojnë me marrëdhëniet e tyre intime dhe/ose më parë intime. Modeli Make a Change u zhvillua nga Respect, në partneritet me Federatën e Ndhmës për Gra e Anglisë (ĒAFE) dhe është frymëzuar nga qasja "Ndryshimi që zgjat".

Make a Change informohet përmes njohjes se abuzimi në familje nuk prek vetëm individët dhe familjet e tyre, por komunitete të tëra. Ai funksionon drejtpërdrejt me njerëzit që përdorin sjellje abuzive dhe kontrolluese, ndërsa fuqizon edhe njerëzit përreth tyre - komunitetet lokale, miqtë, familjet dhe profesionistët - për ta parë veten si pjesë të zgjidhjes dhe për të punuar së bashku për të adresuar problemin.

CLEAR është një fillesë plotësuese dhe e integruar e "Ndryshimit që zgjat", e zhvilluar nga Respect në partneritet me Ēells Ēomen's Aid (Ndihma e grave uellsiane). Ai ofrohet si një kurs i shkurtër pa pagesë për rritjen e ndërgjegjësimit për burrat që shqetësohen për

sjelljen e tyre ndaj grave, i konceptuar si një reagim i hershëm. Të mbijetuarve u jepet mbështetje paralele dhe e veçantë nëpërmjet një shërbimi të integruar të specializuar. Qëllimi është që të ndërhyhet me meshkujt sa më shpejt që të jetë e mundur duke rritur ndërjegjësimin, duke mbështetur ndryshimin e sjelljes dhe duke rritur përgjegjshmërinë. Burrat mund t'i referohen vetë te CLEAR ose mund të referohen nga një profesionist për aq sa merret pëlqimi. Seancat mund të zhvillohen individualisht ose në grup dhe janë të përshtatura për të përmbushur nevojat e secilit individ.

Projekti Drive është një ndërhyrje inovative e abuzimit në familje që synon të zvogëlojë numrin e fëmijëve dhe të rriturve viktimë të dhunës duke prishur dhe ndryshuar sjelljen e kryerësit të dhunës. Projekti fokusohet në kryerës me rrezik të lartë, me dëmtim të lartë dhe/ose kryerës serikë, pasi ky grup mbart rrezikun më të madh të dëmtimit serioz dhe angazhimi me shërbimet në dispozicion është i ulët. Projekti Drive aplikon një qasje të gjithë sistemit duke përdorur menaxhimin intensiv të rasteve së bashku me një përgjigje të koordinuar nga shumë agjenci, duke punuar ngushtë me shërbimet e viktimave, policinë, shërbimin sprovues, shërbimet sociale të fëmijëve, strehimin, keqpërdorimin e substancave dhe ekipet e shëndetit mendor. Ai fokusohet në zvogëlimin e rrezikut dhe rritjen e sigurisë së viktimave duke kombinuar ndërhyrjet e ndërprerjes, mbështetjes dhe ndryshimit të sjelljes së bashku me punën thelbësore mbrojtëse të ofruar nga shërbimet për viktimë.

Ndërtimi i marrëdhënieve më të mira (Mbretëria e Bashkuar)

Ndërtimi i marrëdhënieve më të mira (BBR) është i vetmi program për shërbimin sprovues i bazuar në komunitet në Angli dhe Uells për burrat me rrezik të mesëm dhe të lartë të dënuar për shkelje lidhur me abuzimin në familje ndaj një partneri grua.

Programi BBR është i përshtatshëm për burrat e rritur heteroseksualë që kryen shkelje të abuzimit në familje, duke përfshirë përdorimin e fjalëve dhe sjelljeve kërcënuese, dhe dëmin kriminal. Ky program është krijuar për të promovuar ndryshime të përjetshme në sjellje dhe qëndrime, të cilat, në të kaluarën, kanë rezultuar në dënimin e përdoruesve burra të shërbimeve për dhunë ose abuzim ndaj partnerit intim. Programi BBR i ndihmon përdoruesit e shërbimeve të kuptojnë më mirë ndikimin e agresionit të tyre tek partnerja dhe familjet e tyre. Ai promovon teknika të vetëkontrollit emocional, në mënyrë që ata të përgatiten më mirë për t'u marrë me konfliktet që çojnë në sjellje agresive dhe sfidon të menduarit që mund të justifikojë përdorimin e sjelljes që mund të ketë shkaktuar dëm për njerëzit më të afërt.

Kaizen (Mbretëria e Bashkuar)

Një program trajtimi i akredituar, i ofruar në burgje dhe i synuar ndaj dhunuesve seksualë të dënuar burra, që synon ristrukturimin e qëndrimeve rreth veprave penale. KAIZEN u zhvillua nga Shërbimet e Ndërhyrjes, brenda Shërbimit të Burgut dhe Sprovues.

Kaizen është një program i bazuar në fuqi, i fokusuar në të ardhmen, i cili trajton nevojat kriminojgjene të secilit pjesëmarrës individual në vend që të fokusohet në nevojat që lidhen me një lloj veprë të veçantë. Si i tillë, ai është i ngjashëm me trajtimin individual brenda një mjedisi grupor dhe mund të akomodojë ata me dënime për Dhunë ndaj partnerit intim (DhPI), Delikte seksuale (DS) dhe Dhunë të përgjithshme (DhP).

Kaizen në përgjithësi jepet në baza grupore, me sesione mësimore të mbështetura shtesë që mund të zhvillohen në baza individuale ose në grup të vogël. Kaizen bazohet në modelin bio-psiko-social të ndryshimit, i cili propozon se nevojat kriminojgjene (faktorët e rrezikut)

janë shprehje e proceseve biologjike themelore, ndërvepruese (faktorët gjenetikë dhe neurobiologjikë), proceset psikologjike (përvojat zhvillimore dhe mësimi i hershëm duke përfshirë lidhjen, skema të zhvilluara dhe personaliteti) dhe proceset sociale (ndikimet kulturore dhe sociale). Propozohet që këto procese themelore të ndihmojnë për të shpjeguar pse një individ kryen dhun. Prandaj, programet synojnë të mbështesin pjesëmarrësit për të zhvilluar burime në secilën nga këto fusha nevojash, sipas gjashtë parimeve organizuese të sugjeruara nga Mann & Carter (2012).

Pjesa II: Kurrikula e programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës

Ky propozim për Kurrikulë për profesionistët që punojnë me programet për kryerësit e dhunës synon të ofrojë një pasqyrë mbi strukturën dhe modulet e programeve për kryerësit e dhunës, pasi përdoret në ndërhyrjet me kryerësit e dhunës në familje në MB dhe në vende të tjera evropiane. Në veçanti, kurrikula është ndërtuar mbi programin Respect.

Duke u frymëzuar nga programe të tjera, ideja themelore e këtij dokumenti është të ofrojë një kurrikulë që mund të përdoret në Kosovë dhe që mund të përshtatet lehtësisht me nevojat specifike lokale kur është e nevojshme. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se ky version i kurrikulës fokusohet vetëm tek burrat kryerës të dhunës në familje në marrëdhëniet heteroseksuale (nuk parashikon trajtimin e grave kryerëse të dhunës dhe as të burrave kryerës të dhunës në çiftet e të njëjtit seks) si dhe nuk bën dallime, në këtë fazë, midis djemve, të rriturve dhe burrave të moshuar. Një kurrikulë që synon përdorues të veçantë duhet të modifikohet në përputhje me rrethanat, duke adoptuar një perspektivë gjinore të orientuar drejt grave dhe duke marrë parasysh veçoritë që lidhen me moshën.

Autorët e këtij dokumenti besojnë se kurrikula duhet së pari të zbatohet si një projekt pilot dhe se e gjithë faza eksperimentale duhet të monitorohet nga një studiues i përkushtuar ose ekip studiuesish. Vlerësimi i rezultateve të pilotimit dhe kërkimit do të mundësojë përshtatjen më të saktë të programit me kontekstin dhe nevojat lokale. Sipas specifikave të kontekstit të Kosovës, autoritetet dhe ofruesit e shërbimeve mund të vendosin të modifikojnë këtë version të kurrikulës dhe të përfshijnë module specifike për programet në mjediset kujdestare ose për programet e detyrueshme në mjediset jo-kujdestare. Ata gjithashtu mund të shqyrtojnë dhënien e një kualifikimi kryerësve të dhunës pas përfundimit ose përcaktimit të një procedure të standardizuar në rast të braktisjes së programit. Vendime të tilla nuk duhet të ndërhyjnë në standardet ndërkombëtare dhe as të rrezikojnë sigurinë dhe mirëqenien e viktimave.

1. Objektivat

Programet e Respect-it janë të strukturuar për të nxitur ndryshime afatgjata në qëndrimet, besimet dhe mënyrat e të menduarit të pjesëmarrësve në aftësinë e tyre për të menaxhuar sjelljet dhe emocionet e tyre, me qëllim të ndryshimit afatgjatë të sjelljes (Respekt, Hap pas hapi, Liria). Objektivat kryesore të programit janë:

(1) Për të ndihmuar kryerësit e dhunës të arrijnë njohuri më të mira se:

- Pse përdorin dhunë ndaj partnerit të tyre intim dhe anëtarëve të tjerë të familjes;
- Cilat qëndrime dhe besime mbështesin sjelljen e tyre;
- Cilët faktorë përforcojnë dhe ruajnë përdorimin e tyre të sjelljes së dhunshme në marrëdhëniet intime dhe familjare;
- Cilat taktika abuzive përdorin për të kontrolluar partneren e tyre.

(2) Për të inkurajuar kryerësit që të:

- Identifikojnë, përdorin dhe ndërtojnë fuqitë dhe shkathtësitë ekzistuese për të ndryshuar sjelljen e tyre;
- Identifikojnë sjelljet jo abuzive;
- Vendosin besimet dhe sjelljen e tyre në një kontekst social;
- Pranojnë efektet e abuzimit ndaj të tjerëve.

(3) **Për të rritur motivimin** të angazhojnë pjesëmarrësit dhe të ndikojnë në ndryshim, duke ofruar një mjedis të sigurt, të respektueshëm, stimulues dhe sfidues i cili është i favorshëm për të mësuar.

(4) **Për të mbështetur kryerësit e dhunës në zhvillimin e strategjive praktike dhe të qëndrueshme për ruajtjen e ndryshimit, pasi të ketë përfunduar programi:** çdo javë, seancat specifike të pranimit janë të hapura për të gjithë burrat që kanë përfunduar më parë një program për kryerësit e dhunës, mbi 2 orë dhe në baza të vazhdueshme.

2. Parimet dhe qasjet

Realizimi i një programi për kryerësit e dhunës në familje kërkon një përgjegjësi të konsiderueshme. Profesionistët që ofrojnë programin duhet të sigurojnë që puna të jetë e sigurt dhe efektive dhe, më e rëndësishmja, që në asnjë fazë të mos kontribuojë më tej në dëmin e përjetuar nga viktimat ose të përshkallëzojë rrezikun e abuzimit të mëtejshëm. Huluntimi i bazuar në prova ka treguar se ndërhyrjet e kryera në një mënyrë profesionale dhe kompetente rezultojnë të jenë efektive në krijimin e ndryshimit dhe reduktimin e dëmit (Respect 2020).

Dy parimet më të rëndësishme që duhet të informojnë punën me kryerësit e dhunës në familje janë:

- **Siguria e para:** synimi duhet të jetë gjithmonë rritja e sigurisë dhe mirëqenies së të mbijetuarave dhe fëmijëve të tyre. Stafit duhet të njohë nevojën për ndryshim të sjelljes nga ana e kryerësve të dhunës; megjithatë, prioritet duhet të jetë gjithmonë zvogëlimi i dëmit për viktimën;
- **Mos dëmtimi:** ndërmerri të gjitha hapat e arsyeshëm për t'u siguruar që mbështetja ndaj kryerësve të dhunës të mos përkeqësojë ose gjenerojë rreziqe shtesë për të mbijetuarit dhe fëmijët e tyre.

Edhe pse nuk janë drejtpërdrejt në kontakt me kryerësit e dhunës, agjencitë e përfshira në ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës mbajnë gjithashtu një përgjegjësi të madhe për këtë punë (WWP EN, n.d.). Institucione të tilla kanë për detyrë:

- Që kryerësit e dhunës t'i mbajnë përgjegjës për veprimet e tyre, të marrin përgjegjësi për ndikimin e sjelljes së tyre tek viktimat (gratë dhe fëmijët);
- T'i trajtojnë me respekt kryerësit e dhunës;
- Të krijojnë mjedis të sigurt që lehtëson ndryshimin;
- T'iu mundësojnë kryerësve të emërtojnë besimet e tyre dhe t'i verbalizojnë qëndrimet e tyre në lidhje me gjininë, duke i dhënë përparësi sigurisë së grave dhe fëmijëve.

Në MB dhe në shumë vende evropiane, programet për kryerësit e dhunës në familje ofrohen në mjedise komunitare ose nën shërbimin sprovues (për kryerësit e dhunës të shpallur fajtorë për vepra të lidhura me abuzimin në familje). Sipas udhëzimeve të Respect-it, të gjitha programet e sigurta dhe efektive të ndërhyrjes për kryerësit e dhunës duhet të

sigurohen brenda një **reagimi të koordinuar të komunitetit**, në vend se si një zgjidhje më vete ndaj abuzimit në familje. Kjo do të thotë që programet e përqendruara në standardet e praktikave më të mira duhet të punojnë së bashku me shërbime të tilla si Policia, shërbimet sociale, strehimi, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet mbështetëse të viktimave/të mbijetuarve.

3. Konteksti lokal

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në Kosovë janë një fenomen alarmant i rrënjosur në pabarazinë gjinore dhe i prekur nga normat negative shoqërore dhe zakonet patriarkale. Studimi i parë sasior i kryer nga Rrjeti i Grave të Kosovës vlerësoi se 46% e grave kishin pësuar dhunë në familje të paktën një herë në jetën e tyre dhe se në 91% të të gjitha rasteve të dhunës në familje kryerësi i dhunës ishte burrë (Farnsëorth dhe Qosaj-Mustafa 2008). Përveç shkallës së lartë të prevalencës, një studim cilësor i bazuar në intervista të thella me gra viktimë dhe profesionistë tregoi nivele të gjera të pranimi të dhunës fizike, seksuale dhe ekonomike në marrëdhëniet intime (Rrjeti i Grave të Kosovës 2008). Kohët e fundit, në vitin 2019, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) publikoi “Anketa mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë”, e cila zbuloi se 54% e grave të moshës 18 deri në 74 vjeç që kanë qenë ndonjëherë në një marrëdhënie intime kanë vuajtur nga dhuna fizike, psikologjike ose seksuale nga një partner intim që nga mosha 15-vjeçare. Kjo përqindje ka të ngjarë të nënvlerësohet duke marrë parasysh stigmën rreth dhunës në familje.

Historikisht, zakonet patriarkale dhe besimet e përhapura rreth roleve gjinore kanë kufizuar të drejtat e grave (Paëllak, Krasniqi, Selaci 2016). Përkundër përparimeve të shpejta, edhe në Kosovën bashkëkohore, në mesin e sektorëve të mëdhenj të popullsisë, rolet specifike janë përcaktuar rreptësisht për burrat dhe të tjera për gratë (USAID 2018; OSBE/UNFPA 2018). Edhe pse kjo është më pak e dukshme në familjet me një nivel arsimor më të lartë, burrat pritet të jenë mbajtës të familjes dhe kryefamiljarë, ndërsa gratë kryesisht duhet të marrin përsipër punën e papaguar shtëpiake dhe rritjen e fëmijëve.

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave (CEDAË) është pasqyruar në Nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës të miratuar në maj 2008. Në vitin 2015 Kuvendi i Kosovës miratoi “Pakon e ligjeve për të drejtat e njeriut”, e cila përfshinte legjislacionin e ri për barazinë gjinore, për ndalimin e diskriminimit dhe Ligjin e ri për Institucionin e Avokatit të Popullit (Këshilli i Evropës 2021). Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje është miratuar në vitin 2010, i cili synon parandalimin e dhunës në familje. Në janar 2019, Kodi Penal përfshinte si vepra penale dhunën në familje dhe ngacmimin seksual. Në shtator të vitit 2020 Kuvendi i Kosovës vendosi njëzëri të ndryshojë Kushtetutën për ta bërë Konventën e Stambollit një nga instrumentet juridike ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, e miratuar në janar 2022, është instrumenti kryesor në fushën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, e cila përfshin edhe një objektiv specifik për krijimin dhe zbatimin e programeve për trajtim psiko-social të autorëve të krimeve të dhunshme.

Si pjesë e projektit të bashkëpunimit të Këshillit të Evropës "Përforcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje - Faza III" (2021-2023), një raport që ofron një vlerësim të përafrit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit u lançua në nëntor 2022 (Këshilli i Evropës, 2022). Raporti përcakton rekomandime për veprime të mëtejshme dhe ofron udhëzime praktike për të fuqizuar zbatimin e Konventës së Stambollit në vend. Duke zbatuar metodologjinë e Grupit të

Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), organi i pavarur që monitoron zbatimin e Konventës së Stambollit, ky raport ofron gjetje dhe rekomandime të detajuara në lidhje me pajtueshmërinë lokale me nenin 16 që mbulon detyrimet që lidhen me për ngritjen e programeve të kryerësve të dhunuës.

Raporti i mësipërm vë në dukje se Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe udhëzimet administrative rregullojnë trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe trajtimin e detyrueshëm mjekësor për kryerësit e varur nga alkooli dhe droga, por në praktikë, disponueshmëria e programeve për kryerësit e dhunës mbetet e kufizuar. Sipas Udhëzimeve Administrative që rregullojnë programet për kryerësit e dhunuës, trajtimet psiko-sociale mund të ofrohen nga institucionet shëndetësore, institucionet sociale dhe ofruesit e licencuar të shërbimeve sociale (përfshirë OJQ-të), ndërsa trajtimi mjekësor për shkelësit me probleme të varësisë duhet të bëhet nga institucionet mjekësore. Institucionet shëndetësore, veçanërisht qendrat e shëndetit mendor, janë subjektet kryesore që ofrojnë të dyja llojet e programeve në praktikë. Në mjediset e paraburgimit, Shërbimi Korrektues i Kosovës zbaton programin e terapisë grupore konjitive-sjellëse mbi “Menaxhimin e Zemërimit”.

Raporti vinte në dukje se programeve të mësipërme u mungojnë standardet uniforme për prioritizimin e sigurisë së grave viktime dhe të drejtave të tyre njerëzore. Kështu, është e paqartë se deri në çfarë mase ata kryejnë vlerësim të rregullt të rrezikut dhe adresojnë stereotipet negative gjinore që përjetësojnë dhunën ndaj grave. Si kufizim, raporti theksoi se disa programe trajtimi të ofruara në institucionet shëndetësore publike priren të fokusohen në menaxhimin e zemërimin, në vend që të inkurajojnë kryerësit të marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre. Raporti shtoi se “fakti që shërbimet e shëndetit mendor janë entet kryesore publike që ofrojnë të gjitha programet ekzistuese për kryerësit e dhunës, ka shkaktuar shqetësim për qasjen e ngushtë mjekësore të ndërhyrjeve për kryerësit”.

Përveç kësaj, raporti i mësipërm nënvizoi se dy OJQ, Qendra SIT në Prishtinë dhe Shtëpia e Sigurt e Grave në Gjakovë, kanë krijuar programe pilot të trajtimit psiko-kognitiv të cilat tentojnë të përmbushin më mirë standardet ndërkombëtare. Megjithatë, ai theksoi se programe të tilla të drejtuara nga OJQ-të për kryerësit kanë marrë vetëm mbështetje të kufizuar financiare për të drejtuar programe të tilla.

E themeluar në Gjakovë në vitin 1999, Shtëpia e Sigurt është një nga strehimoret më të vjetra në Kosovë dhe një nga të parat që është licencuar (OSBE 2019). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka akredituar punën e saj në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe me kalimin e viteve është njohur për punën e saj me gratë viktime të dhunës në familje. Në vitin 2019, gjatë një periudhe prej nëntë muajsh, gjashtë burra ndoqën një program të bazuar në takime individuale dhe në punë në grup. Shumica e tyre ishin kryerës të dhunës në familje pa ndonjë problem specifik të shëndetit mendor apo problem varësie, ndërsa dy burra u referuan në shërbimet e specializuara shëndetësore pas një vlerësimi individual. Gjatë programit pilot, takimet me kryerësit e dhunës janë mbajtur në një objekt të veçantë të ofruar nga rrjeti i OJQ-ve të grave “Qeliza” në Gjakovë. Një psikolog dhe këshilltar psikosocial drejtuan çdo seancë duke përdorur një qasje kongnitive të sjelljes dhe lojëra me role të marra nga modeli Duluth.

Qendra SIT është një organizatë joqeveritare me seli në Prishtinë dhe aktivitetet kryesore të saj janë këshillimi, shërbimi social dhe hulumtimi. Seancat aktuale të këshillimit në qendrën Sit bazohen kryesisht në një qasje kongnitive të sjelljes, e cila përfshin gjithashtu punë psiko-edukative dhe aktivitete me role. Trajtimi synon të ofrojë udhëzime praktike dhe teknika për vetë-menaxhimin emocional dhe përmirësimin e shkathtësive të komunikimit

ndërpersonal. Është e vetmja organizatë në Kosovë e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Punës me Kryesit e Dhunës. Referimet në qendrën SIT deri më tani janë bërë nga institucionet, grupet e interesit dhe rastet e vetë-referuara (Këshilli i Evropës 2021).

Për të përmirësuar organizimin vendor të programeve për kryerësit e dhunës, në përputhje me detyrimin që përmban neni 16 i Konventës së Stambollit, raporti i mësipërm mbi përafrimin e masave me Konventën e Stambollit rekomandon fuqimisht që autoritetet:

- a. të hartojnë standarde minimale të cilësisë për të gjitha programet për kryerësit e dhunës në familje, të cilat duhet të vendosin në qendër të tyre sigurinë e viktimave dhe të drejtat e tyre të njeriut dhe që duhet të përfshijnë bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet programeve për kryerësit e dhunës dhe shërbimeve të specializuara që ndihmojnë viktimat;
- b. të shtojnë numrin e programeve të disponueshme, të detyrueshme dhe vullnetare, për të siguruar disponueshmërinë e tyre në të gjithë territorin bazuar në standardet minimale të cilësisë;
- c. të sigurojnë që vlerësimi i jashtëm i programeve të tilla të kryhet dhe në përputhje me praktikën dhe parimet më të mira të njohura ndërkombëtarisht, duke përfshirë analizën e informacionit të besueshëm për përsëritjen e veprës penale, në mënyrë që të vlerësohet nëse programet i shërbejnë qëllimeve të synuara parandaluese;
- d. të sigurojnë që programet për kryerësit e dhunës në familje të jenë pjesë e një qasjeje nga agjenci të shumta duke përfshirë të gjitha institucionet përkatëse, përfshirë OJQ-të; dhe
- e. të sigurojnë trajnim adekuat për të gjithë fasilitatorët e programeve të kryerësve të dhunës.

4. Struktura dhe kohëzgjatja

Programet e kryerësve të dhunës në familje janë programe të ndërhyrjes afatgjata të ofruara për një periudhë prej 6 deri në 8 muaj. Çdo seancë mund të zgjasë nga 60 minuta deri në 3 orë, në varësi të modelit të ndërhyrjes dhe kontekstit. Është shumë e rëndësishme që seancat të mbahen në të njëjtën ditë çdo javë, për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të ndihmuar pjesëmarrësit të përfshijnë takimet në rutinën e tyre javore.

Programi për kryerësit e dhunës në familje përbëhet nga tri faza:

- (1) Marrja/vlerësimi (seanca individuale)
- (2) Ndërhyrja (seanca në grup)
- (3) Përfundimi dhe vlerësimi (duke kombinuar seanca individuale dhe grupe)

FAZA 1	
Marrja/vlerësimi (seanca individuale)	2 deri në 4 javë
<p>Një periudhë kohore që synon të vlerësojë përshtatshmërinë e pjesëmarrësve për programin dhe nivelin e tyre të motivimit për të ndryshuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Përdorni një grup pyetësorësh, pyetjesh të hapura dhe intervista motivuese për të drejtuar këto seanca ● Kryeni një vlerësim të rrezikut (vlerësoni dhe adresoni çdo çështje sigurie për viktimën dhe fëmijët e tyre, merrni parasysh historinë e dhunës) ● Eksploroni gatishmërinë e pjesëmarrësve për të reflektuar mbi sjelljet abuzive të kaluara dhe aktuale me qëllim ndryshimin (të kini parasysh mohimin, minimizimin, turpin) ● Prezantoni gjatësinë, përmbajtjen dhe metodat e programit ● Informoni ata për kërkesat për përfundimin dhe detyrimet e tyre (matni vullnetin për të ndryshuar, motivimin) ● Adresoni konfidencialitetin 	

Çdo takim zgjat 60 deri në 90 minuta dhe zhvillohet në një mjedis zyre, pasi duhet kushtuar vëmendje sigurisë së fasilitatorit.

Rregulla që duhen respektuar për t'iu bashkuar ndërhyrjes në grup:

- Jini të gatshëm dhe të aftë për të punuar në grup
- Shkuarja me kokë të kthjellët dhe jo nën ndikimin e drogës dhe/ose alkoolit (pjesëmarrja në seancë nuk do të lejohet nëse shfaqen të dehur gjatë seancave)
- Angazhohuni të merrni pjesë në të gjitha seancat, të arrini në kohë dhe të merrni pjesë aktivisht
- Tregoni gatishmëri për të pranuar përgjegjësinë për abuzimin dhe përkushtimin për të ndryshuar sjelljen
- Ndaloni sjelljet e dhunshme ose abuzive ndaj kujtdo
- Trajtoni fasilitatorët me respekt dhe respektoni konfidencialitetin e pjesëmarrësve të tjerë
- Nënshkruani një formular pëlqimi për t'i mundësuar ofruesit dhe profesionistëve të tjerë të përfshirë të ndajnë informacione rreth angazhimit dhe përparimit të tyre

(DAPP, CAF/CASS on record, MB, 2020)

FAZA 2

Ndërhyrja (seanca në grup, një herë në javë, 2 orë)

4 deri në 8 muaj

Formati i grupit është ndërhyrja kryesore në programet për kryerësit e dhunës. Seancat në grup përbëhen nga maksimumi 10-12 pjesëmarrës dhe zhvillohen nga 2 fasilitator me ekuilibër gjinor. Ndërhyrja fillon duke ofruar dy ose tri seanca orientuese, për të krijuar një mundësi që pjesëmarrësit të takohen me njëri-tjetrin, të vendosin rregullat e grupit dhe të mundësojnë bashkimin e më shumë pjesëmarrësve.

Seancat realizohen në baza javore, shpesh mbahen jashtë "orarit të punës" (d.m.th., mbrëmje, fundjavë) dhe zgjasin nga 90 deri në 120 minuta. Fasilitatorët ndjekin një sekuencë të qartë hapash gjatë çdo seance, për të ndihmuar pjesëmarrësit të zhvillojnë një rutinë, që mund të ulë ankthin e tyre dhe të inkurajojë pjesëmarrjen. Në fillim të çdo seance, trajnuesi do t'i kujtojë secilit nga rregullat e grupit, duke vënë në dukje rëndësinë e konfidencialitetit dhe respektit. Ata gjithashtu do të ndajnë agjendën e seancave me grupin dhe do të ofrojnë material për seancat. Disa nga seancat më të vështira mund të zgjaten nga 15-30 minuta, për të lënë kohë për teknikat e informimit ose relaksimit (ndërgjeshmëri, ushtrime të frymëmarrjes, etj.).

Programi për kryerësit e dhunës bazohet në 10 tema, secila prej të cilave do të trajtohet në 2 deri në 4 seanca, për të siguruar kohë të mjaftueshme për të mësuarit reflektues. Metodatat e diplomuara mundësojnë prezantimin e pjesëmarrësve me temën, që përfshijnë: prezantimin e modulit, pjesëmarrjen aktive, diskutimet e strukturuar që përfshijnë ndërgjegjësimin për vlerat, ushtrimet për të kuptuarit dhe zhvillimin e vetvetes dhe ndikimin e sjelljes së tyre të dhunshme tek viktimat (gratë dhe fëmijët).

FAZA 3	
Përfundimi dhe vlerësimi (duke kombinuar seanca individuale dhe grupore)	Minimumi 1 muaj
<p>Gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, pjesëmarrja e pjesëmarrësve incizohet nga trajnuesit dhe në fund të çdo seance merren shënime reflektuese. Kjo nuk është vetëm për të monitoruar pjesëmarrjen dhe angazhimin, por edhe për të vlerësuar progresin dhe për të evidentuar çdo reagim të kërkuar nga referuesit, ose nga viktima, në fund të ndërhyrjes.</p> <p>Përfundimi i një programi për kryerësit e dhunës nuk shënohet në vërtetim; megjithatë, në disa raste mund të kërkohen raporte të hollësishme nga gjykatat ose agjencitë e tjera, në lidhje me angazhimin, aktivitetin dhe dëshminë e ndryshimit të qëndrimeve dhe besimeve të pjesëmarrësit dhe të njohurive të tij për ndikimin e dhunës mbi viktimat (gra dhe fëmijë).</p> <p>Vlerësimi është një hap shumë i rëndësishëm i çdo programi për kryerësit e dhunës dhe duhet të zhvillohet dhe përshtatet me ndërhyrjen sipas objektivave të tij. Përveç vlerësimit të brendshëm të shërbimit, programet duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi vjetor të kryer nga një vlerësues i jashtëm, duke ftuar të gjitha palët përkatëse të interesit të përfshirë në matjen e ndryshimit, rezultateve dhe efektivitetit të kostos së ndërhyrjeve të programit (për më shumë informacion, shih më poshtë “7. Vlerësimi).</p>	

5. Ofrimi i programit dhe ofruesit e shërbimit

Disa subjekte mund të ofrojnë programe për kryerësit e dhunës, duke përfshirë institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile (OJQ). Megjithatë, të gjitha subjektet duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Një nga elementët më kritikë të ofrimit të programeve të suksesshme për kryerësit e dhunës në familje është aftësia e ofruesit të shërbimit për t'u bërë pjesë e një qasjeje me shumë-agjenci, duke siguruar partneritete të forta dhe shkëmbim informacioni. Kjo do të ndikojë në cilësinë e ndërhyrjes si dhe në rritjen e referimeve dhe ofrimin e mbështetjes jetike për viktimat dhe të mbijetuarat. Shërbimet që janë të gatshme të marrin përsipër realizimin e programit për kryerësit e dhunës, për të siguruar që kanë kapacitet organizativ për të ofruar një program që kërkon angazhim afatgjatë. Ofruesit e shërbimit duhet të sigurojnë që ata të kenë:

- Kapacitet menaxhues;
- Staf të trajnuar dhe shumë të motivuar;
- Hapësirë të përshtatshme të sigurt;
- Burime financiare.

5.1 Profesionistë të përfshirë

Sipas praktikës dhe standardeve ndërkombëtare, disa profesionistë mund të përfshihen në ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës, duke përfshirë psikologë, psikiatër, punëtorë socialë, trajnerë, avokatë, aktivistë, etj. Në varësi të çdo konteksti kombëtar, ekipet profesionale multidisiplinare mund të merren me kryerësit e dhunës në familje, individualisht ose në grupe. Megjithatë, është e një rëndësie të madhe që stafi që realizon programin për

kryerësit e dhunës të ketë përvojë në punën me gratë viktime të dhunës në familje dhe të dijë se si të merret me dinamikën e pushtetit dhe kontrollit. Stafi duhet të kalojë nëpër trajnime të specializuara fillestare dhe në shërbim dhe të ketë mbikëqyrur takime të rregullta (individuale ose grupe). Trajnimi i profesionistëve mund të promovohet duke nxitur zhvillimin e njohurive dhe kompetencave specifike për dhunën në familje, me një perspektivë specifike gjinore. Mundësitë e trajnimit mund të përfshijnë vendimmarrës dhe agjenci ligjore, si dhe kategori të ndryshme profesionale. Disa veprime mund të kontribuojnë në rritjen e shkathësisë profesionale, të tilla si pjesëmarrja në vizita studimore, shkëmbime trajnimi dhe takime me profesionistë nga vende të tjera ose me organizata anëtare të WWP EN.

Shembuj të profilit të profesionistëve

Në MB, të gjitha programet e kryerësve të dhunës në familje ofrohen nga organizata të akredituara (Respect 2012) dhe kërkesa kryesore për praktikuesit/profesionistët e përfshirë në realizimin e drejtpërdrejtë është trajnimi i plotë në një nga programet e ndërhyrjes të njohura dhe të akredituara.

Përgatitjet profesionale ndryshojnë dhe nuk ka asnjë kërkesë minimale arsimore për fasilitatorët. Kjo shpesh i fuqizon ish-kryerësit e dhunës (pas përfundimit të suksesshëm të një programi për kryerësit e dhunës) të trajnohen dhe të përfshihen drejtpërdrejt në mbështetjen e të tjerëve për të ndryshuar sjelljet, mendimet dhe ndjenjat e tyre rreth pushtetit dhe kontrollit, nëpërmjet bashkë-fasilitimit. Megjithatë, shumica e fasilitatorëve vijnë nga psikologjia, psikoterapia, shërbimi korrektues dhe sprovues, kujdesi shëndetësor, kujdesi social dhe arsimimi profesional. Ata përgjithësisht mbajnë diploma BA, Master dhe PHD. Përveç përfundimit të trajnimit dhe marrjes së akreditimit për një program të ndërhyrjes në abuzimin në familje (trajnimi i trajnerëve të grupit të Respect-it), të gjithë trajnerët janë trajnuar edhe për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve të pambrojtur, dhe shumica kanë të paktën një kualifikim për këshillim.

Programet ofrohen gjithmonë nga dy fasilitator, një burrë dhe një grua, të dy të trajnuar dhe të akredituar në ofrimin e një programi për kryerësit e dhunës.

5.2 Procedurat e licencimit

Në këtë fazë, është e parakohshme të vendosen procedura të përcaktuara licencimi për shërbimet që ofrojnë programe për kryerësit e dhunës. Autorët e këtij dokumenti sugjerojnë që, pas aplikimit eksperimental të projektit pilot dhe vlerësimit të tij, Grupi Punues për zhvillimin e programeve për kryerësit e dhunës në Kosovë mund të përpunojë udhëzime kombëtare dhe procedura specifike të licencimit për ofruesit e shërbimeve (mundësisht duke bërë dallimin ndërmjet programeve të detyrueshme dhe vullnetare). WWP EN aktualisht është duke punuar në një "model evropian të akreditimit të programeve për kryerësit e dhunës". Pasi të miratohen, programet për kryerësit e dhunës të ofruara në Kosovë mund të përputhen me këtë model në mënyrë që të jenë në përputhje me një grup standardesh ndërkombëtare.

Shembuj i procedurave të licencimit

Në Mbretërinë e Bashkuar, Respect është subjekti përgjegjës për akreditimin e programeve për kryerësit e dhunës. Organizata tregon se standardet e akreditimit zbatohen "për të gjitha organizatat që ofrojnë programe për parandalimin e dhunës në familje (PPDhF) që punojnë me burra që përdorin dhunën ndaj partnerit intim (DhPI), dhe gjithashtu ofrojnë shërbime të integruara të sigurisë (ShIS) për partnerët dhe ish-partnerët e këtyre kryerësve të dhunës". (Respect 2012, 1). Ata përshkruajnë zhvillimin e akreditimit në mënyrë që njerëzit të mund të sigurohen për një "shërbim me cilësi të lartë të fokusuar në siguri nga organizata të akredituara nga Respect". Puna me kryerësit e dhunës dhe viktimat është njësia minimale e Respect që kërkohet për t'u konsideruar për akreditim.

Qëllimet e një shërbimi të akredituar nga RESPECT përfshijnë (Respect 2012):

- rritjen e sigurisë së viktimave,
- vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut,
- të bërit pjesë e një reagimi të komunitetit ndaj abuzimit në familje,
- dhe ofrimin e shërbimeve që njohin një komunitet të larmishëm, i cili përfshin të qenit i qasshëm, promovimin e marrëdhënieve të respektueshme, punën me përgjegjësi, mbështetjen e ndryshimeve shoqërore dhe ofrimin e një përgjigjeje të plotë.

Ekzistojnë dy faza të akreditimit duke përfshirë praktikën minimale të sigurt, e cila përfshin vlerësimin dhe përmbushjen e shumicës së kriterëve, dhe akreditimin e plotë, ku një organizatë plotëson të gjitha 94 kërkesat në standard. Materialet e akreditimit më pas vijojnë të detajojnë këto kriterë nën një seri titujsh rreth menaxhimit të organizatës, strukturave dhe procesit të shërbimit, diversitetit, menaxhimit të rrezikut, fëmijëve dhe punës në partneritet.

Modeli bazohet në praktikën feministe dhe fokusohet në përdorimin e dhunës nga një burrë si një mekanizëm instrumental për të ushtruar dhunë dhe kontroll mbi partneren e tij grua. Programet duhet ta pasqyrojnë këtë duke siguruar që kryerësi i dhunës të mbahet plotësisht llogaridhënës dhe përgjegjës për dhunën e tij, e cila konsiderohet një sjellje në të cilën ai ka zgjedhur të përfshihet. Parimet këtu shprehin qartë se “gatishmëria për të zgjedhur të përdorë sjellje të dhunshme dhe abuzive ndaj një partneri ndikohet nga pritshmëritë e mësuara dhe një ndjenjë e së drejtës së bazuar në gjini” (Respect 2012, 28) dhe “mohimi dhe minimizimi i sjelljes abuzive ose ndonjë justifikim për përdorimin e sjelljes abuzive duke përfshirë përdorimin e drogës ose alkoolit” (Respect 2012, 29) .

6. Referimi në program

Në procedurën e tij të vlerësimit nga-vendi-në vend, GREVIO ka theksuar se autoritetet kombëtare nuk duhet të zgjerojnë vetëm numrin e programeve të disponueshme, por edhe llojet e shërbimeve, duke ofruar programe vullnetare dhe të detyrueshme, në mjediset e shërbimeve korrektuese dhe jo-korrektuese. Megjithatë, programet për kryerësit e dhunës nuk duhet të përdoren kurrë, në asnjë rrethanë, si alternativë ndaj procedimeve penale. Meqenëse dhuna në familje shpesh raportohet më pak dhe shkalla e dënimit është shpesh ende e ulët, programet e detyrueshme përfundojnë duke arritur vetëm tek një pakicë kryerësish, duke lënë jashtë një numër të konsiderueshëm burrash të dhunshëm të cilët nuk janë referuar për asnjë trajtim. Për këtë arsye, pjesëmarrja vullnetare duhet të jetë gjithashtu e disponueshme, duke synuar autorë të disa formave dhe shkallëve të abuzimit, duke përfshirë djem të ekspozuar më parë ndaj dhunës që mund të riprodhojë potencialisht modele të sjelljes abuzive. Sigurimi i programeve të detyrueshme dhe vullnetare konsiderohet një mënyrë për të parandaluar rrezikun e një përshkallëzimi të dhunës.

Programet e bazuara në drejtësinë penale zakonisht drejtohen nga personeli i shërbimit sprovues ose korrektues dhe marrin vetëm referime nga gjykatat penale si pjesë e një dënimi për dhunë në familje. Nga ana tjetër, programet vullnetare të bazuara në komunitet zakonisht drejtohen nga një organizatë e sektorit vullnetar ose pjesë e një partneriteti të sektorit vullnetar/statutor dhe mund të pranojnë edhe vetë-referime. Të dy llojet e programeve duhet të vendosin protokolle të formalizuara për t'u koordinuar me shërbimet e specializuara të mbështetjes së grave. Në veçanti, është e rëndësishme të krijohet një procedurë e sigurt e kontaktit me viktimën për të kontaktuar partneret e kryerësve të dhunës (Respect, 2018).

Programet për kryerësit e dhunës janë të hapura për të gjithë burrat 18+ që duan të reduktojnë nivelin e tyre të rrezikut për të tjerët. Referimet vijnë nga një sërë burimesh si gjykatat familjare, shërbimet sociale, policia ose vetë-referimi.

Gjatë periudhës së vlerësimit pjesëmarrësit do të informohen se:

- Ata që nuk duan të angazhohen do t'u kërkohet të largohen nga dhoma sapo kjo të shfaqet;
- Të pranishmit nuk mund të humbasin asnjë nga seancat pasi ata do të hiqen nga programi aktual që po ofrohet;
- Konfidencialiteti zbatohet në atë që kryerësit e dhunës duhet të ndihen të sigurt në vetvete dhe duhet të ndjehen të sigurt për të folur në grup.

6.1. Shembull i programeve për kryerësit e dhunës në mjediset korrektuese dhe në komunitet

Programet në mjediset korrektuese

Në MB, shumica e programeve për kryerësit e dhunës në familje për të burgosurit e dënuar si kryerës të dhunës në familje ofrohen nga OJQ të akredituara dhe organizata bamirëse të specializuara, megjithatë ato financohen dhe mbikëqyren nga menaxhmenti i burgut dhe Ministria e Drejtësisë. Shërbimi i Burgut dhe Sprovues i Madhërisë së Saj (HMPPS) mbështesin disa programe të akredituara që, si pjesë e një pakete më të gjerë rehabilitimi, synojnë dhunën në familje. Ato ofrojnë gjithashtu programe të specializuara të akredituara për kryerësit e dhunës në familje për të burgosurit e dënuar për krime të dhunës në familje ose të tjerë që mund të jenë identifikuar si kryerës të dhunës në familje dhe duan të ndryshojnë.

Programet mbahen në objektin e burgut, në një zonë të sigurt komunikimi dhe realizohen sipas të njëjtave standarde si ato të ofruara në mjediset e komunitetit. Monitorimi me video i realizimit të punës në grup është një praktikë e përdorur në burgje dhe mostrat e këtyre videove përdoren shpesh nga menaxheri i trajtimit. Aspektet e administrimit janë të njëjta me ato në mjediset e komunitetit; duke ndjekur programin dhe procedurat siç thuhet në manualin e programit, madhësinë e grupit, gjininë dhe konsistencën e trajnerëve.

Programet në mjedisin e komunitetit

Programet për kryerësit e dhunës në familje në MB, kur ofrohen në komunitet, ofrohen në vende të ndryshme. Shumica e grupeve do të takohen në objektin e një organizate të specializuar të akredituar që ofron programin; megjithatë, shpesh mund të përdoren hapësira alternative për të reduktuar rrezikun. Vendndodhja e takimeve të grupit merret gjithmonë në konsideratë në lidhje me vendndodhjen e viktimës, distancën nga shtëpia, universiteti, vendi i punës, shkolla e fëmijëve etj., kur vlerësohet rreziku. Siguria e viktimës dhe fëmijëve të tyre mbetet parësore.

Kur kryerësi i dhunës ka një kërkesë për program të akredituar në dënimin e tij ose një kusht lejimi për të përfunduar një ndërhyrje, referimi do të vijë nga praktikuesi i shërbimit sprovues. Referimet merren gjithashtu nga punëtorë socialë dhe profesionistë të tjerë të kujdesit social me pëlqim të nënshkruar nga individit. Megjithatë, grupet janë të hapura për vetë-referime dhe çdo njeri që dëshiron të ndryshojë sjelljen e tij, është i mirëpritur të bashkohet.

Gjatë vlerësimit, praktikuesi do të identifikojë nivelin e motivimit të pjesëmarrësit dhe nëse duhet të ndërmerret ndonjë punë shtesë përpara se një individ t'i bashkohet grupit.

7. Vlerësimi

Hulumtimi i bazuar në prova mundëson njohuri më të mirë të praktikave të komunitetit dhe gjyqësorit. Kjo vlen edhe për programet për kryerësit e dhunës, ku vlerësimi mundëson identifikimin se "çfarë funksionon" me kryerës të ndryshëm të dhunës dhe në rrethana të ndryshme. Integrimi i procedurave të vlerësimit në konceptimin, zhvillimin dhe zbatimin e një programi për kryerësit e dhunës gjithashtu nënkupton që burimet e duhura njerëzore dhe financiare duhet të ndahen për këtë qëllim. Është e rëndësishme të theksohet se autoritetet politikë-bërëse dhe financuesit janë kryesisht në kërkim të ndërhyrjeve që janë të përshtatshme për kontekstin lokal dhe që janë efektive, efikase dhe të qëndrueshme. Kjo është edhe më e rëndësishme në kontekstet e shënuara me qasje të kufizuara në burime.

Edhe pse disa studime kanë identifikuar metoda dhe strategji për të vlerësuar programet për kryerësit e dhunës, kjo kurrikulë fokusohet kryesisht në parimet e përpunuara nga projekti evropian IMPACT¹⁴ dhe projekti britanik MIRABAL (Kelly, Ëestmarland 2015). Të dy programet kanë përqafuar një nocion të gjerë të "suksesit", i cili nuk kufizohet vetëm në përfundimin e programit apo në matjen e recidivizmit nëpërmjet statistikave gjyqësore. Matja e rezultateve të një programi përfshin një sërë treguesish që synojnë të marrin në konsideratë ndryshimin në qëndrimet dhe sjelljet e kryerësit e dhunës. Projekti IMPACT zbuloi se pjesëmarrja në program, "përveç promovimit të reduktimit të dhunës në familje, ka të ngjarë të ndryshojë natyrën e dhunës së kryer dhe të zvogëlojë rrezikun e viktimizimit. Do të ndryshonte qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj grave dhe përdorimit të dhunës në përgjithësi, dhe dhunës gjinore në veçanti" (BFEG 2016, 36). Projekti MIRABAL shënon një zhvendosje nga qasja tradicionale e vlerësimeve ndaj programit për kryerësit e dhunës, duke nënvizuar se vlerësimi i ndikimit të programeve për kryerësit e dhunës duhet të konceptohet në bazë të përvojës dhe perspektivës së viktimave. Prandaj propozon 6 tregues për të matur efektivitetin e programit:

- (1) Komunikim me respekt dhe marrëdhënie të përmirësuara;
- (2) Hapësirë e zgjeruar për veprim;
- (3) Siguri dhe liri nga dhuna dhe abuzimi për gratë dhe fëmijët;
- (4) Prindërim i sigurt, pozitiv dhe i përbashkët;
- (5) Ndërgjegjësim i zgjeruar i vet vetvetes dhe të tjerëve;
- (6) Fëmijëri më të sigurt dhe më të shëndetshme.

Këta tregues integrojnë një pyetësor që duhet të plotësohet nga të dy pjesëmarrësit në program (kryesit e dhunës) dhe partnerët ose ish-partnerët e tyre dhe duhet të plotësohet në kohë të caktuara (në fillim, në gjysmë të rrugës dhe 12 muaj pas fillimit të programit). Ky lloj vlerësimi ofron një sasi të madhe të dhënash sasiore dhe cilësore që mund të jenë jashtëzakonisht të dobishme për ofruesin e shërbimit, aktorët gjyqësorë, menaxhimin e rasteve të koordinuara ndërinstitucionale në komunitet. Zbatimi i këtyre treguesve tregon gjithashtu se thjesht raportimi i "programit të përfunduar" ose regjistrimi "nuk ka më raste të

¹⁴ Instrumenti i monitorimit të rezultateve të IMPACT të WWP EN, gjendet këtu:

https://www.work-with-perpetrators.eu/fileadmin/WWP_Network/redakteure/IMPACT/WWP_ImpactToolkit_A5_publication_ëeb.pdf

dhunës në familje" janë kritere të pamjaftueshme për të matur efektivitetin e një ndërhyrjeje të programit për kryerësit e dhunës.

Pjesa III: Modulet dhe përmbajtja e trajnimit

1. Format e dhunës/abuzimit në familje

Raporti shpjegues i Konventës së Stambollit Përkufizimi i "dhunës në familje"

